



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 3730 Prishtinë, Dt. 25-09-2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Shkencave Matematike dhe Natyrore
Departamenti/ Programi	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Projektpropozimi	Analiza e përbërjes kimike të vajrave esenciale të llojit <i>Achillea millefolium</i> nga popullatat natyrore në Kosovë
Kandidati	Hana Gashi
Mentori	Prof. Dr. Behxhet Mustafa
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 07.05.2024 Vendimi nr.: 1515
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Tema e masterit "Analiza e përbërjes kimike të vajrave esenciale të llojit <i>Achillea millefolium</i> nga popullatat natyrore në Kosovë" e kandidatës Hana Gashi është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyor, përkatësisht në laboratorin e Ekologjisë së Bimëve. Tema është realizuar sipas procedurave dhe dinamikës së paraparë në programin e punës të paraqitur së bashku me kërkesën për vlerësimin të projekt-propozimit të temës.</p> <p>Dorëshkrimi është shkruar në 45 faqe, me rralor 1.5 ku janë përfshirë këta kapituj: Abstrakti, Abstract (në gjuhën Angleze), Hyrja, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet dhe diskutimi, Përfundimi, Literatura dhe Biografia. Në punim janë të prezantuara 11 figura dhe 1 tabelë. Kandidatja gjatë shkruarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të mjaftueshme duke cituar 78 artikuj shkencor dhe burime tjera të literaturës.</p> <p>Në kapitullin Hyrje, kandidatja përshkruan rendësin e këtij hulumtimi, biologjinë e llojit <i>Achillea millefolium</i>, emërtimet, përdorimin etnobotanik dhe përdorimet komerciale, përbërjen kimike, si dhe efektet farmakologjike dhe toksikologjike të llojit të përzgjedhur për këtë studim. Po ashtu, kandidatja adreson qartë qëllimin e këtij hulumtimi.</p>

Në kapitullin Materiali dhe metodat, kandidatja përshkruan në detaje materialin dhe metodat e përdorura në këtë hulumtim, përfshirë dizajnin e punës eksperimentale, mënyrën e mbledhjes së materialit bimor, ekstraktimit të substancave bioaktive nga materialit bimor, mënyrën e analizimit të komponimeve kimike të marra për studim, si dhe metodat statistikore të përdorura për analizimin e rezultateve.

Në kapitullin Rezultatet dhe diskutimi, kandidatja përshkruan dhe analizon rezultatet e gjetura për sasinë e përbërësve kimik të vajrave esenciale të llojit *Achillea millefolium*, si dhe variabiliteti të tyre ndërmjet popullatave të ndryshme. Për secilin komponent të analizuar ka dhënë mesataren, në tabelën përkatëse. Po ashtu kandidatja për të adresuar variabilitetin fitokimik ndërmjet popullatave të analizuar, duke përdorur analizën statistikore të komponentëve parësore. Gjetjet e veta, me theks të veçantë përqendrimin e komponimeve kryesore të vajrave esenciale kandidatja i ka krahasuar me gjetjet e autorëve të tjerë.




Në kapitullin Përfundimi, kandidati jep një rezymë të rezultateve të arritura. Në bazë të rezultateve të fituara kandidatja konstaton se përbërësit kryesorë të vajrave esenciale ishin trans-krizantenil acetati, borneoli, kamazuleni, β -pineni, 1,8-cineoli, γ -terpineni, kamfori dhe α -terpineoli. Sasia por edhe përbërja kimike vajit esenciale ishte e ndryshme dhe në varësi të origjinës së materialit bimor. Analizat statistikore tregojnë ekzistencën e tre grupeve kryesore. a. mostra me përqendrim të lartë të trans-krizantenil acetat dhe 1,8-cineol; b. mostra me përqendrim të lartë të borneol, dhe c. mostra me përqendrim të lartë të kamazulen dhe β -pinene.

Nga ajo që u tha më lartë dhe bazuar në punën e bërë nga kandidatja, mund të konkludohet se rezultatet e fituara në këtë punim paraqesin kontribut për njohjen e përbërjes kimike dhe variabilitetit të këtyre komponimeve ndërmjet popullatave dhe ndërmjet individëve të të njëjtës popullate të llojit *Achillea millefolium* ndërsa kandidatja ka fituar njohuri për hulumtime të mëtejme në të ardhmen në këtë lëmi.

Këshillit Shkencor-Mësimor të Departamentit të Biologjisë dhe të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore i propozojmë që të aprovoj këtë raport dhe kandidatit Hana Gashi ti lejoj mbrojtjen e temës.

Prishtinë, 20.09.2024

Komisioni:

1. 
/Prof. Dr. Avni Hajdari - anëtar (mentor)/
2. 
/Prof. Dr. Behxhet Mustafa - kryetar/
3. 
/Prof. Dr. Avdulla Alija - anëtar/